


MASKA

*Revista Elektronike
Radio e RII në gjuhën shqipe
Nr.5 Mars i vitit 2017.*



Zyra Federale e Hetimeve (FBI) në vitin 1987

ka publikuar një përmbledhje të strukturës së formimit, përbërjes, ideologjisë dhe procesit të shfaqjes së grupit MEK. Në këtë raport është theksuar se informacionet e mbledhura janë informacione publike dhe nuk përshkruajnë plotësisht këtë organizatë. Raporti është përpiluar në bazë të disa librave hulumtues, artikujve të

Tre parimet kryesore të kësaj organizate ishin:

Islami është një fe e gjallë dhe revolucionare, i cili mund të analizohet nëpërmjet dialektikës marksiste. Rezistenca e armatosur është e vetmja taktikë për tu përballur me imperializmin.

Të gjitha lëvizjet e tjera opozitare dhe kundërshtarë në Iran kanë dështuar, pasi nuk kanë pasur strukturë efikase marksiste.

Në raportin e FBI thuhet se pikënisja e veprimtarisë së dhunshme dhe e përdorimit të forcës nga MEK daton në vitin 1971 dhe në përpjekjet e këtij grupi për të prishur ceremoninë festive të 2500 vjetorit të



revistave dhe gazetave të ndryshme, shkrimet e MEK dhe burime të tjera.

Në raportin e vitit 1987 të FBI-së thuhet: Organizata MEK e cila në vitin 1963 u formua nga disa anëtarë të pakënaqur të lëvizjes çlirimtare të Iranit, ka kryer disa akte terroriste në mesin e vitit 1971 që kishte për qëllim të prishte festën 2500 të mbretërisë në Iran. Ky raport historikun e aktiviteteve të MEK e ka ndarë në 3 pjesë:

Historiku para fitores së revolucionit islamik në vitin 197

Historiku gjatë vitores së revolucionit në vitin 1979
Dhe historiku pas fitores së revolucionit e deri në publikimin e raportit

Përpara fitores së revolucionit islamik, një grup gueriles të rinjsh të sapo diplomuar të universitetit të Teheranit, krijuan në mënyrë të fshehtë organizatën e pavarur e quajtur Organizata Muxhahedin-e-Khalk.

sistemit mbretëror në Iran. Në atë kohë një prej anëtarëve të arrestuar të MEK ka zbuluar planin për prishjen e kësaj ceremonie dhe më pas u arrestuan 70 prej anëtarëve të tjerë të MEK. Siç thotë një prej ish pjesëtarëve të shërbimit informativ të mbretit të Iranit, i njohur me emrin Savak, depërtimi i agjentëve të këtij shërbimi në mesin e grupit MEK bëri të mundur arrestimin, burgosjen dhe dënimin me vdekje të shumë prej anëtarëve të grupit në fjalë, mes tyre disa prej themeluesve të MEK. Në atë kohë një prej anëtarëve të grupit mori në dorë drejtimin e MEK dhe në këtë mënyrë nisi të zgjerohej ndikimi i Masud Raxhavi kreu aktual i grupit MEK.

Në vitin 1973 liderët e grupit MEK ishin kishin prirje tek ideologjia dhe teoria marksiste. Ata studionin revolucionet e kryera në Azi, Amerikën latine dhe botimet e ish Bashkimit Sovjetik. Në mesin e vitit 1974, ky grup ishte përgjegjës për trazirat që u bënë nëpër fabrika dhe punishte dhe nëpër aeroportet e

Iranit. Pikërisht në këtë vit, kërret e MEK theksuan ndërthurjen e ideologjisë marksiste me ideologjinë e MEK.

Grupi terrorist MEK mori përsipër përgjegjësinë e vrasjes së disa amerikanëve. Sipas këtij raporti, terroristët e grupit MEK janë përgjegjës për vendosjen e bombave dhe vrasjen e konsulentëve ushtarak amerikanë në Iran gjatë vitit 1972. Grupi MEK ka marrë përsipër përgjegjësinë për vrasjen e Herold Price oficer i forcave ajrore të Amerikës, Luis Houkinz komandant i forcave ajrore, Pol Shefer major i forcave ajrore dhe Xhek Turner komandant i forcave ajrore të Amerikës, vrasje që janë bërë në vitin 1972 në vitin 1973 dhe 1975. Grupi MEK gjithashtu ka marrë përsipër përgjegjësinë për vrasjen e civilëve amerikanë punëtorë të projektit mbrojtës të vitit 1976, si dhe disa përgjegjës për sigurinë në Iran. Ky grup është përgjegjës edhe për bombat e vendosura në zyrën e kompanisë së naftës dhe kompanisë ajrore të Iranit. Qëllimi i këtyre vrasjeve ishte tërheqja e vëmendjes tek opozita iraniane, frikësimi i shtetasve amerikanë dhe depërtimi në Savak. Ky raport flet për nisjen e kryesisë së Masud Raxhavi në vitin 1975 në grupi MEK dhe thotë: Grupi i drejtuar prej Raxhavi ka vazhduar rezistencën e armatosur në të gjitha aspektet. Një prej gazetarëve të njohur të kohës i cili ndodhej në Iran shkruan “MEK në shtypin e vet haptazi ka folur mbi vrasjen e 5 amerikanëve në Iran dhe mbi përpjekjet për të destabilizuar regjimin e Shahut. Thuhet se Raxhavi personalisht ka dhënë urdhër për vrasjen e këtyre amerikanëve”. Ky raport mbi pozitën e grupit MEK, përgjatë revolucionit të vitit 1979 shkruan: MEK ishte i mendimit që të ndiqte lëvizjen e madhe popullore të shiitëve të kryesuar nga imam Khomeini, mirëpo ky grup vazhdoi përdorimin e forcës dhe të dhunës me qëllim që ulte fuqinë politike të Iranit përballë kundërshtarëve. Raporti flet për rolin e MEK në peng marrjen e kryer në ambasadën amerikane në Teheran dhe thuhet se MEK ka ndërhyrë gjerësisht në pushtimin e ambasadës amerikane në Teheran në vitin 1979. Dëshmitë dhe faktet tregojnë se MEK ka drejtuar sulmin në ambasadë dhe më pas i ka kërkuar immit që të mos lirojë pengjet

amerikane dhe të mos bisedojë me qeverinë amerikane. Hetimet e Kongresin flasin se Raxhavi në atë kohë ka insistuar pranë immit duke thënë se përfitimet nga mbajtja e pengjeve janë më të larta sesa lirimi i tyre.

Raxhavi pëson disfatë përballë forcave revolucionare.

Historia e grupit MEK që nga viti 1979 e deri në publikimin e raportit, është përqendruar në privimin e këtij grupi nga pjesëmarrja në qeveri. Si rezultat Masud Raxhavi në vitin 1981, bëri përlogaritje katastrofike dhe përkrahësve të tij u dha urdhër që të dalin nëpër rrugë për një rezistencë të armatosur. Mirëpo anëtarët e grupit MEK nuk arritën të dalin fitimtarë përballë forcave të revolucionit dhe si rezultat Raxhavi së bashku me disa bashkëpunëtorë të tij mori vendim që të largohet nga Irani për të shkuar në Paris. Aktivitetet e armatosura të MEK u shtuan shumë në vitin 1981. Në Gusht të atij viti MEK shpërtheu një bombë në zyrën e kryeministrit të Iranit, duke marrë jetën e presidentit Raxhavi dhe të kryeministrit Bahonar. Raporti flet për mosmarrëveshjen mes Raxhavi dhe Bani Sadr në pranverë të vitit 1984 dhe për shpërbërjen e këshillit kombëtar të rezistencës dhe thotë: Raxhavi në programin e tij të thithjes së fondeve dhe të forcave, grupin MEK e ka quajtur Këshilli Kombëtar i Rezistencës. Raporti i FBI flet për aktivitetet e MEK për thithjen e ndihmave financiare nga Evropa dhe Amerika dhe për aktivitetet ushtarake të këtij grupi. Në atë kohë qeveria franceze u kërkoi Raxhavi dhe bashkëpunëtorëve të tij që të largohen nga territori



francez. Si rezultat Raxhavi u largua nga Franca dhe në vitin 1986 organizatën MEK e transferoi në Irak.

Në vitin 1987 grupi MEK në kufirin mes Iranit dhe Irakut ngriti një kamp të gjerë ushtarak me 10 mijë forca dhe duke kaluar kufirin gjatë natës, kryente sulme kundër Iranit. Përhapja dhe thithja e forcave nga MEK u shtua shumë, ndërkohë që në vitin 1987 u shtuan edhe ndihma financiare për këtë grup. Grupet mbështetëse të MEK të cilët veten e tyre e quanin Organizata Muxhahedin-e-Khalk i Iranit, Muxhahedin, Këshilli Kombëtar i Rezistencës, ishin formuar pothuajse në të gjitha vendet perëndimore si Kanada dhe Amerikë. Këto grupe mbështetëse të cilët kryesisht formoheshin nga studentë dhe të rinj iranianë, në vitin 1987 kanë mbledhur me milion dollarë ndihma dhe kanë organizuar tubime të mëdha në qytete të ndryshme të Amerikës, Kanadasë, Evropës dhe Lindjes së Mesme. Ata arritën të mbledhin armëve, municione, mjete dhe pajisje ushtarake nga qeveritë mbështetëse sidomos ajo e Irakut si dhe arritën të marrin mbështetjen e shumë politikanëve të njohur mes tyre 2 mijë deputetë lokalë dhe kombëtar. Në pjesën e dytë të raportit të vitit 1987 të FBI-së flitet për situatën e këtij grupi në kohën e publikimit të raportit.

Sulmet e MEK kundër Iranit

Liderët e MEK në vitin 1987, kanë pranuar ndërhyrjet e tyre të shumta ushtarake në Iran. Ata kanë thënë se dega ushtarake e grupit e njohur me emrin Ushtria Çlirimtare Kombëtare është e përbërë nga 10 mijë forca dhe krerët e MEK vazhdimisht kanë publikuar lajme dhe artikuj mbi përleshjet e kësaj ushtrie me ushtrinë e Iranit. P.sh. në numrin e fundit të gazetës “ Çlirimi i Iranit”, lexuesve u është përcjellë lajmi se Ushtria Çlirimtare e Iranit prej janarit ka vlarë 3 mijë forca të ushtrisë iraniane. Forcat e grupit MEK, vazhdimisht kanë sulmuar pjesëtarët e ushtrisë së Iranit, qendrat e telekomunikacionit dhe pikat kufitare. Natën ata sulmonin pikat e vrojtimit kufitar, pikat e kontrollit në kufi, sulmonin ushtarët, i arrestonin ushtarët dhe përpara sesa të ktheheshin në Irak, brenda territori iranian vendosnin bomba. Në raport thuhet se lajmet e publikuara nga MEK mbi këto ngjarje janë tepër të ekzagjeruara. Në sektorin e jashtëm grupi MEK ka bërë përpjekje politike dhe diplomatike kryesisht në Kanada dhe Amerikë për ta paraqitur veten si Muxhahedin-e-Khalk.

Mbledhja e ndihma financiare nga MEK në Amerikë

Në këtë raport gjithashtu është folur për mënyrën e mbledhjes së fondeve dhe forcave nga ana e MEK. Përgjegjësinë për mbledhjen e këtyre fondeve dhe forcave e kanë pasur instituti i studentëve myslimanë të Iranit dhe fondacioni donator për Iranin. Prej vitit 1984, anëtarët e MEK kanë shkuar shtëpi më shtëpi nëpër qytetet e ndryshme të Amerikës për të mbledhur fonde ndihme për grupin në fjalë. Në një raport të saj Departamenti Amerikan i Shtetit në vitin 1987 ka raportuar se Fondacioni Donator për Iranin që ndodhet në rrugën Key North West të Uashingtonit, jo vetëm që është i varur nga MEK por është mbështetës dhe mbulues i këtij grupi. DASH thotë se ky fondacion punon për të mbledhur fonde në ndihmë të MEK. Mulli Sinkler një prej gazetarëve të Uashington post në vitin 1985 ka shkruar se Fondacioni Donator për Iranin në Meriland dhe Virxhinia që nga koha e formimit e deri në vitin 1984 ka arritur të mbledhë shumën prej 97 mijë e 230 dollarë. Ata anëtarë të Mek të cilët janë anëtarë të institutit të studentëve myslimanë të Iranit, gjithashtu janë munduar të mbledhin fonde dhe aktiviteti i tyre është përqendruar më shumë në ambientet universitare të botës. Ky grup ka mbledhur ndihmat financiare të studentëve përkrahës iranianë dhe jo iranianë. Instituti i studentëve myslimanë të Iranit, mund të ketë thithur edhe forca për grupin MEK. Në një kohë kur prokuroria e përgjithshme e Amerikës, institutin në fjalë e konsideron organ mbulues të MEK, thotë se ky institut ka arritur të vendosë lidhjen mes bazës së MEK në Bagdad dhe studentëve iranianë në të gjithë botën. Zyrat e këtij instituti në universitetet amerikane, ka përhapur broshura dhe artikuj të MEK dhe ka organizuar seminare të këtij grupi.

Grupi MEK publikon lajme të pavërteta mbi shkeljen e të drejtave të njeriut në Iran

Sipas raportit të FBI, grupi MEK duke nxjerrë një gazetë prej 6 faqesh, mundohet të përhapë lajme të pavërteta lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut në Iran dhe për të propaganduar kundër qeverisë iraniane.

MEK ka zgjedhur marksizmin

Në raportin e FBI thuhet se ideologjia e MEK bazohet në bindjet se shiizmi është feja bazë e grupit ndërsa kuadri politik është i bazuar tek marksizmi. Raporti i vitit 1987 i FBI, ideologjinë

themelore të MEK e ka ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë konsiston në kundërshtimin e plotë të imperializmit amerikan duke e cilësuar atë armikun kryesor të revolucionarëve. Ky grup ishte e mendimit se ajo çka ndodh në Iran lidhet me këtë pjesë. Pjesa e dytë thekson se fuqia politike, sociale dhe ekonomike duhet të jetë në shërbim të ideologjisë. Grupi ishte i mendimit se nëse veprimtaria qëndron mbi ideologjinë atëherë nuk mund të arrihet një shoqëri islame ideale. Teoricienët dhe ideologët e MEK në analizat e tyre rreth Iranit të shekullit të 20-të thonë revolucionin i vitit 1905 shoqërinë iraniane e ktheu nga një shoqëri feudale në një shoqëri broshura e cila është e lidhur tejmas me kapitalizmin perëndimor dhe është i dominuar nga imperializmi sidomos ai amerikan. Sipas tyre, në vitin 1960 imperializmi, kulturor, ekonomik, politike dhe ushtarak

anëtarëve dhe përkrahësve të MEK. Në këtë fjalim Raxhavi thotë: Ky gjykim do të përfundojë sot ose nesër në darkë. Ndoshta këto janë momentet e fundit të jetës sonë. Nëse nuk dënohemi me vdekje, do të dënohemi me burgim të përjetshëm. Regjimi po kryen këtë gjykim pasi lëvizja dhe kryengritja e popullit është zgjeruar dhe se shqetësimi i ndërkombëtare mbi gjendjen e të burgosurve politikë në Iran është shtuar. P.sh. Pol Sarter ka kërkuar që të marrë pjesë në gjykim. Al-Fatah për të na mbështetur ka nxjerrë një revistë speciale dhe radio e Irakut ka lexuar emrat e të gjithë të burgosurve politikë në burgjet e Shahut të cilët janë kërcënuar se do të marrin dënimin me vdekje. Në këtë mënyrë regjimi Pahlavi ka arritur në përfundim se organizimi i këtij gjyqi është në interesin e tij. Secilit prej nesh na është dhënë gjysmë ore kohë për tu vetëmbrojtur. Duke qenë se



kërcënonte seriozisht ekzistencën e Iranit. Mek thoshte se pushteti mbretëror Pahlavi përveç shtresës aristokrate dhe të lartë, kishte shumë pak përkrahje nga shtresat e tjera. MEK në artikujt e tij ka insistuar në përdorimin e forcës heroike për të zgjuar popullin dhe për të fundosur shoqëritë shtypëse.

Fjalimi i Masud Raxhavi në burg

Më poshtë jepet një prej fjalimeve të Masud Raxhavi në vitin 1972 në kohën kur ndaj tij po mbahej proces gjyqësor. Siç thotë Surush Erfani, ky fjalim përpara fitores së revolucionit islamik në vitin 1979, është përhapur gjerësisht në mesin e

unë nuk kam kohë të mjaftueshme për të bërë mbrojtjen time, ata që më ndjekin mua do të vazhdojnë të bëjnë mbrojtjen tonë rreth realitetit ekonomike politik, historik dhe logjik të organizatës dhe rezistencës tonë revolucionare. Imperializmi ndërkombëtar është shkaku kryesor i të këqijave dhe vuajtjeve të të gjithë njerëzve në këtë fazë të historisë. Imperializmi në të gjithë botën posedon regjime të varura prej tij. Këto regjime si të mbështeten tek vetja e tyre dhe si të mbështeten tek popullit, edhe për një ditë nuk mund të vazhdojnë jetën e tyre. Sot në botë ekzistojnë dy fronte. Në një anë ndodhet përkrahësit e popullit, nevojtarëve, të privuarëve, të pastrehëve dhe të shtypurve, të uriturve dhe të palestinezëve

revolucionarë dhe kryengritës dhe nga ana tjetër ndodhen të pasurit, poseduesit e puseve të naftës, industritë e mëdha dhe makineritë e luftës. Kompromisi mes këtyre dy fronteve as që mund të diskutohet. Ne krenohemi për atë që ju e quani krim. Krenohemi që ndodhemi përkrah revolucionarëve të tjerë për të shkatërruar imperializmin dhe për tu përballur me sionizmin. Përballë nesh ka vetëm dy opsione: Ose të rezistojmë ose të dorëzohemi. Ose duhet të rezistojmë njëloj si vietnamezët, kinezët dhe palestinezët, ose duhet të bëhem robër ashtu siç ishte Shahu i Iranit. Problemet gjatë kohës së rezistencës janë të shumta. Mirëpo njeriu nuk mund të pastrohet pa patur vuajtje dhe dhimbje. Kur them këto fjalë në mendje më kujtohen nënat dhe baballarët që fëmijët e tyre i kanë në burg. Mirëpo kjo është filozofia e jetës. Fëmijët e tyre i zhdukin nga aspekti fizik. Mirëpo mëngjesi është afër dhe duhet të vazhdojmë. Unë dhe shokët e mi jemi bij të dr. Musadekut dhe ndjekës të rrugës së tij për liri dhe pavarësi kombëtare. Ne i kemi kthyer shpinën pushtetit dhe pasurisë. Ishte populli ai që solli në pushtet dr. Musadekun që ai të punonte për të kombëtarizuar industrinë e naftës. Qeveria e tij ishte e vetmja qeveri legjitime që ka përjetuar kombi ynë. Mirëpo ata e rrëzuan Musadekun dhe kundërshtarët e regjimit të Shahut i vranë në mënyrë masive. Pas kësaj dyert për grabitjen pa karar të pasurisë së Iranit, u hapën. Të ardhurat nga nafta përdorshin për blerjen e armëve dhe për të paguar pagat e konsulentëve ushtarakë amerikanë. Sot regjimi e sheh që për të vazhduar jetën e tij duhet të vesh një petk të ri. Regjimi po mundohet të bëjë reforma strukturore dhe të ndajë aksionet me punëtorët e fabrikave. Mirëpo e vërteta është se regjimi po ecën në drejtim të imperializmit. Që nga koha e grushtit të shtetit kundër dr. Musadekut në vitin 1953, u shtua shumë korrupsioni në aparatet shtetërore dhe kjo ushtroi presion të madh tek njerëzit dhe sidomos tek shtresa e përvuajtur e shoqërisë. Shikoni gjendjen në Teheran. Nëse ndonjë i varfër sëmuret ai është i detyruar të qëndrojë në pritje përballë deryve të spitaleve deri sa vdekja t'i vijë. Banuesit e gërmadhave përreth Teheranit nuk kanë gjë për të humbur, përveçse fatkeqësi të tyre. Nëpër fshatra keqpërdorimi që u bëhej fshatrave nga padronët e tyre, tani bëhet nga qeveria. Këto janë vetëm një pjesë e faktorëve që krijuan kushtet për revolucion. Në kushtet kur zëri protestues dhe kundërshtues i popullit shtypet, atij nuk i mbet gjë tjetër veçse të nisë rezistencën e

armatosur. Prokuroria e regjimit për të ndihmuar propagandën e regjimit na ka akuzuar se shpërdorojmë valutën e vendit për të blerë armatime. Duam të pyesim: Ne jemi ata që shpenzojmë kapitalet e vendit në valutë dhe kemi shitur vendin? Kush janë ata që kanë transferuar kapitalet në bankat zvicerane? Kush është pronar i hoteleve, klubeve të natës dhe i kazinove? Nëse Shahu të gjitha këto nuk i ka përfituar duke vjedhur kombin, atëherë babai i tij është ai që ka vjedhur. Ne jemi ata që kemi shpërdorur kapitalin valutor të vendit, apo ata që mendojnë për sende luksoze, apo për rroba dhe veshje të klasit të lartë? Ata që shpenzimet e një ditë janë tepër të larta. Burimet tona të naftës shkojnë në xhepat e të tjerëve. Nëse kjo rrjedhë vazhdon, nafta e Iranit do të përfundojë deri në vitin 1987. Prodhimi aktual i naftës në Iran është 227 milion ton në vit. Me çmimin e naftës 10 dollarë, e cila shitet akoma më shtrenjtë në tregjet e Evropës, Irani përfiton vetëm 1.3 miliard dollarë. Z. Prokuror, kushtojini vëmendje këtij fakti dhe jo shpenzimeve që ne bëjmë për blerjen e armëve. Me qindra milion dollarë shkojnë në xhepat e kompanive të huaja. Kryetari i komisionit të programimit, në një konferencë të tij ka njoftuar se me qindra miliona dollarë janë vjedhur. Ne na ishte premtuar se me të ardhurat e naftës, Irani do të kthehej në një vend me mirëqenie të lartë, mirëpo populli është varfëruar akoma më shumë. Të drejtat e popullit iranian janë mohuar. Në kohën kur punëtorët e fabrikave të tullave dhe kallëpeve u futën në grevë, ushtarët ndaj tyre qëlluan me armë dhe vranë 200 punëtorë. Ushtarët e dr. Khan Ali kanë vrarë mësuesit e futur në grevë dhe shumë prej tyre i plagosën. Mësuesit dhe punëtorët e fabrikave kanë kërkuar vetëm një pagë më të lartë. Megjithatë ata morën plumbat, ndërsa vrasësve të tyre iu ngritën gradat. Në kohën kur regjimi kërkesave të popullit u përgjigjet në këtë formë, a mund të qëndrojë heshtur dhe të mos marrim armët? Kombi ynë është shtypur me armë dhe shigjeta. Për tu përballur me këtë shtypje të popullit, edhe klerikët të cilët janë tërhequr për 50 vjet me radhë, tani janë aktivizuar në lëvizjen kundër regjimit Pahlavi. Në Kum është bërë kryengritje. Studentët fetarë u janë kundërvënë ushtarëve dhe kanë vrarë dy prej tyre. Kjo shkaktoi kryengritjen e klerikëve, tregtarëve, studentëve dhe në fund përfundoi me vrasjen e qershorit të vitit 1963. Pas kësaj ata arritën në përfundimin se me përdorimin e arsyes dhe logjikës nuk mund t'i kthejnë të drejtat e popullit iranian. Ata përdorën

Kuranin dhe Nehxhul'Balaganë për të nisur një lëvizje të re revolucionare. Përkrah Muxhahedin-e-Khalk, janë shfaqur edhe grupe të tjera revolucionare me qëllim që të mbrojnë dinjitetin njerëzor. Bashkimi i këtyre revolucionarëve me rrjedhën e rezistencës tregon se kushtet aktuale janë të atilla që i kanë detyruar me qindra të rinj që bëjnë kryengritje me armë. Kjo tregon se rezistenca jonë nuk është për ambiciet e një personi të caktuar. Me qindra nga mjekët dhe inxhinierët më të mirë janë futur në këtë rrugë. Dhjetëra vite më parë grupet opozitare kryenin aktivitetet e tyre në mënyrë të fshehtë, mirëpo sot ne kemi marrë armët. Kjo është vetëm pikënisja e rezistencës. Ne e dimë se nuk do të arrijmë një fitore të lehtë dhe të shpejtë. Imam Aliu thotë: Zoti, shtypësit dhe sunduesit do t'i shkatërrojnë në kohën e duhur. Ai atyre u jep afat që të futen në rrugën e drejtë. Në rast se ata nuk futen në këtë rrugë, atëherë për ta nuk ka rrugëzgjdhje tjetër veçse fundi. Në atë kohë përgjegjësinë do t'ia japë popullit me qëllim që drejtësia hyjnore të vendoset. Zoti nuk do të shërojë plagët e asnjë populli pa vuajtje dhe mundim. Regjimi Pahlavi me zgjerimin e programit të kapitalizmit mundohet të devijojë të rinjtë tanë nga rruga e drejtë. Regjimi Pahlavi në vend që të krijojë kushtet për të ngritur njohuritë politike dhe sociale të të rinjve tanë, duke krijuar "Pallatin e të rinjve" mundohet të përhapë degjenerimin dhe imoralitetin. Me të tilla veprimi regjimi mundohet të pengojë të rinjtë që ata të mendojnë dhe zgjidhin problemet reale të tyre dhe të shoqërisë. Shtypja bëhet në formë të egër me qëllim që shpirti rezistues dhe kryengritës i popullit të zhduket dhe ai popull të mos ketë më shpresë. Forcat e armatosura janë vendosur dhe pozicionuar nëpër universitete. Buxheti i Savakut ka arritur në miliona. Askush nuk mund të futet në punë nëse nuk merr konfirmimin e Savakut. Policisë dhe Savakut u

janë dhënë kompetenca të pafundme me qëllim që të shtypin kundërshtarët politikë. Kreu i burgut "Gezel Kala" u ka dhënë urdhër punonjësve të tij që të sillen me të burgosurit ashtu siç kasapi sillet me delet. Regjimi nuk pranon kurrfarë opozite apo kritike. Punëtorët të cilët kërkonin rritjen e pagave të tyre, janë sulmuar nga ushtarët të cilët vranë 12 punëtorë. Disa muaj më parë ushtarët sulmuan universitetin e Teheranit dhe universitetin e Arjashahrit. Në këtë sulm u goditën edhe mësuesit dhe profesorët. Regjimi nuk dëshiron të bëjë asgjë përveçse të shtojë shtypjen. Kjo tregon dobësinë e regjimit. Të burgosurit politikë torturohen dhe shumë prej tyre kanë humbur jetën nga torturat. Sipas nenit 131 të kushtetutës, nëse ndonjë funksionar është përgjegjës për vdekjen e të burgosurve politik, ai duhet të dënohet njëlloj si një vrasës apo kriminel. Megjithatë vrasësit e të burgosurve politikë, lëvizin lirshëm dhe marrin grada. Djegia e trupit të të burgosurit me avull të nxehtë, heqja e thonjve, goditjet me kamxhik, goditjet në organe gjenitale, janë disa nga metodat torturuese të përdorura kundër të burgosurve. Ndaj Masud Ahmedzade, kanë përdorur shkop të lyrë me acid. Ahmedzade përpara vdekjes, ka luftuar me dhimbjet për dy muaj me radhë. Nuk mund të duroi kur dëgjoni këto fjalë. Nuk pres që ky regjim çnjerëzor të sillet ndryshe me ne. Për këtë arsye jemi ngritur kundër tij. Ne jemi në pritje që populli ynë tradhtarët t'i nxjerrë në bankën e të akuzuarve. Vdekje imperializmit amerikan. Rrofshin ata që kanë duruar dhimbjet dhe vuajtjet për revolucionin dhe lirinë.



Grupi Monafekin nga pretendimi për luftë kundër imperializmit deri te një vegël në duart e imperializmit

Tridhjetë e tetë vite më parë në botë ndodhi

një ndryshim i cili nuk ishte parashikuar në asnjë mënyrë. Xhimi Karter kur mori pushtetin dhe u bë president i Amerikës, ai u zgjodh vetëm për një mandat dhe nuk arriti të zgjidhet për mandatin e dytë për shkak të humbjes së Iranit. As ai në Amerikë nuk kishte arritur të parashikojë një ndryshim ka të madhe.

Ndodhi Revolucioni Islamik dhe deri më tani kanë kaluar 38 vite që bota as edhe për një çast nuk ka mbyllur sytë ndaj këtij rajoni në Lindjen e Mesme. Në Iran kanë ndodhur lloj-lloj ngjarje dhe janë kryer krime të ndryshme. Gjatë tetë viteve të mbrojtjes së lavdishme, në këtë rajon ishin testuar edhe armët më të sofistikuara të Lindjes e të Perëndimit dhe kapitali i të gjitha vendeve ishte vendosur në dispozicion të Sadam Husejnit në këtë luftë për ta mundur Iranin.

Ngjarjet terroriste në Iran nga dy aspekte janë të pashembullta:

Nuk mund të gjendet asnjë vend gjatë gjithë historisë që brenda një viti funksionarët më të lartë të tij të jenë vrarë nga grupet terroriste. Presidenti, kryeministri, kryetari i Gjykatës së Lartë, shumica e ministrave dhe një numër i madh i deputetëve të Parlamentit përkrah mijëra qytetarëve të tjerë, janë vrarë vetëm përgjatë një viti. Kjo është e pashembullt!

Grupet që kanë kryer këto veprime terroriste dhe këto krime, në botë kanë zyra zyrtare dhe janë nën mbështetjen e vendeve të ndryshme perëndimore, sidomos të Amerikës, prandaj edhe kjo çështje është e pashembullt.

Në vitin 1997, Departamenti Amerikan i Shtetit ka kryer hetime shumë të sakta në lidhje me grupin terrorist Muxhahedine Khalk. Instituti "Rend" gjithashtu me porosinë e Pentagonit, përgjatë dy viteve ka kryer hetime të gjera frontale në lidhje me të gjitha sjelljet e grupit Muxhahedine Khalk. Departamenti Amerikan i Shtetit në mënyrë zyrtare thotë se ky grup me veprimet e tij terroriste ka

vrarë me mijëra njerëz duke përfshirë funksionarë shtetëror dhe qytetarë të thjeshtë. Presidenti i Iranit, kryeministri i Iranit, kryetari i Gjykatës së Lartë të Iranit së bashku me mijëra qytetarë të pafajshëm të Iranit janë vrarë nga ky grup terrorist.

Tani është interesant fakti se ky grup ka zyre zyrtare në të gjitha vendeve evropiane. Zyre ka gjithashtu edhe afër Shtëpisë së Bardhë. Gjatë mandatit të presidentit amerikan Barak Obama, ky grup u hoq nga lista e organizatave terroriste dhe këtij grupi iu dha një zyrë afër Shtëpisë së Bardhë. Donald Trump këshilltarët më të njohur i ka ata njerëz të cilët për çdo vit marrin pjesë në mitingjet e grupit Muxhahedine Khalk që zhvillohen në Paris dhe duke marrë shumën më të madhe të parave, mbajnë fjalime në interes të këtij grupi. Kjo mbështetje e pastër dhe e hapur e vendeve perëndimore bëhet ndaj një grupi që sipas vet atyre ka vrarë funksionarë shtetëror dhe qytetarë të thjeshtë të Iranit. Edhe kjo çështje është e pashembullt në historinë e vendeve të botës. E dimë se Amerika e krijoi ISIS. Znj. Klinton në librin e tij "Opsioni i vështirë", në mënyrë të qartë pohon "ne e krijuam Al Kaidan". Mirëpo Al Kaida në asnjë vend të botës nuk ka zyre zyrtare! Gjatë mandatit të presidentit Bill Klinton, një makinë ishte duke kaluar në shkretëtirat e Jemenit, kur një anije luftarake amerikane nga Gjiri Persik e goditi atë me raketë dhe deklaroi se një prej liderëve të Al Kaidas ishte në atë makinë. Pra kur rreziku i kërcënon, ata veprojnë në këtë mënyrë, do të thotë që sipas tyre ekziston terrorizëm i mirë dhe terrorizëm i keq!

ISIS gjithashtu, deri në kohën ku kryente krime vetëm në Azi dhe Afrikë, perëndimorët nuk morën kurrfarë qëndrimi. Mirëpo që nga koha kur terroristët e ISIS ua prenë kokën disa pengjeve amerikane dhe të vendeve perëndimore dhe arritën të hyjnë edhe në këto vende, atëherë filluan qëndrimet e ashpra dhe veprime kundër terrorizmit.

Grupi Muxhahedine Khalk është shndërrua në një prej mjeteve më kryesore të vendeve perëndimore kundër Iranit. Ata 35 vite më parë kanë kapur armët në dorë dhe kanë bërë të gjithë atë çfarë kanë patur mundësi në krime e tradhti kundër popullit të Iranit dhe përkrah Sadamit e Amerikës. Për ata u bë e qartë se nuk kanë kapacitet për ta gjunjëzuar

Republikën Islamike të Iranit me metoda të tilla, prandaj filluan ta ndjekin çështjen e të drejtave të njeriut. OKB deri më tani ka miratuar 50 rezoluta kundër Republikës Islamike të Iranit për çështjen e të drejtave të njeriut që bazë kryesore për miratimin e këtyre rezolutave ishin pikërisht këto grupe terroriste.

Bazë kryesore e sanksioneve që u vendosen kundër Iranit, gjithashtu ishte grupi Muxhahedine Khalk. Çështja e programit bërthamore dhe problemet që u krijuan, në prapaskenën e të gjitha këtyre ishte grupi terrorist Muxhahedine Khalk. Në luftën e imponuar të Iranit kundër Irakut, gjithashtu ky grup ka spiunuar për Sadam Husejnit dhe për forcat e tij.

Njerëzit duhet të njihen me mashtrimet dhe komplotet e grupit Muxhahedine Khalk. Ata nuk janë vetëm një grup i armatosur, por ata kanë edhe ide të ndërthura dhe eklektike të cilat në fillim të Revolucionit tërhoqën mendjen e shumë njerëzve. Këto ide janë krijuar nga përzierja e Islamit me

Që nga viti 1963 kur filli Revolucionit i Iranit dhe deri në fitoren e tij, të gjithë përkrahësit dhe figurat e Revolucionit nuk kanë përdorë armë, por mbanin fjalim, jepnin deklarata, informonin njerëzit, burgoseshin nga regjimi, mirëpo kurrë nuk kanë përdorur armë në këtë rrugë. Çfarë ndodhi që papritur një grup i të rinjve 19-20 vjeçar formuan një grup dhe kapën armët në emër të shiizmit dhe islamit dhe revolucionarizmit?!

Ky grup kur dërgoi disa përfaqësues të tij në Naxhaf, Imam Khomejni (ra) tre ditë me radhë dëgjoi fjalët dhe mendimet e tyre, pastaj në fund tha: "Pas tre ditëve, unë u thash këtyre se nuk e pranoj metodën tuaj dhe kjo është për dy arsye: njëra është se mendimet tuaja janë të ndërthura dhe eklektike dhe nuk përfaqësojnë islamin e vërtetë dhe të drejtë, ndërsa tjetra kur të kapni armët njëkohësisht i jepni rast regjimit të mbretit që tu shkatërrojë të gjithë juve".

Në fund, aktualisht po e shikoni se ky grup terrorist



Marksizmin. Brenga kryesore e Shehid Beheshti ishte përballja me ide të tilla, mirëpo ata krijuan një atmosferë të atillë që shumë njerëz u futën në dyshim dhe dilema duke hedhur edhe slogane "Vdekje Beheshtit", por pas vrasjes së tij njerëzit menjëherë e kuptuan se çfarë gabimi të madh kanë bërë.

është shndërruar në një vegël në duar të Amerikës. Do të thotë i njëjti grup i cili ishte krijuar për të luftuar kundër imperializmit, sot është shndërruar në një vegël në duart e imperializmit kundër shtetit të Iranit.

Sejed Xhavad Hasheminezhad, sekretar i përgjithshëm i Fondacionit Habilian

Intervistë e "Habilian" me djalin e dëshmorit

Fejz Mohamed Husejnber.

Kur kanë kaluar 50 vite nga krijimi i grupit Monafekin, ky grup në ditët e fundit të jetës së tij i është drejtuar dhe kërkon shpëtim nga imperializmi perëndimor. Ky grup i cili fillimisht u krijua në vitin 1965, pas fitores së Revolucionit Islamik në Iran, kërkoi pjesë nga Revolucioni dhe në përputhje me ideologjinë e tij marksiste u distancua nga klerikët, duke filluar vrasjen e shokëve të Imam Khomeinit (ra) dhe të përkrahësve të Revolucionit. Anëtarët e grupit Monafekin përmes reklamave të rreme të udhëheqësve të tyre dhe premtimeve boshe, krijuan iluzione dhe thjesht u përkulën përballë kërkesave të tyre, duke vrarë një numër të madh të bashkatdhetarëve të tyre. Krerët e këtij grupi të cilët veten e konsideronin mbrojtësit e vërtetë të popullit, shkuan në drejtim të tyre. Martir Fejz Mohamed Husejnber, është një nga dëshmorët e Ehli Sunetit që u godit me 40 plumba zemërimi dhe urrejtje të monafekinëve. Martir Fejz Mohamed Husejnber ka lindur me 2 gusht 1945 në fshatin Gres (në provincën Sistan Baluchestan). Prindërit e tij merreshin me bujqëri dhe i takonin klasës së mesme të shoqërisë. Ai në moshën 7 vjeçare filloi mësimin në shkollë dhe pas përfundimit të shkollës fillore, shkoi në fshatin Zengian për të vazhduar shkollimin. Ai atje ishte nxënës i Mulla Abdulaziz Sadati, ndërsa më pas shkoi në Karachi të Pakistanit për të vazhduar studimet. Ai pas arritjes së shkollës Mulla u kthye në vendlindje dhe filloi aktivitetet revolucionare dhe për zhvillimin e diturisë. Ai më 12 Maj 1981 u martirizua nga elementët e grupit terrorist Monafekin.

Gjatë intervistës së zhvilluar me djalin e martir Feiz Mohamed Huseinber, ai tha:

"Në fshatin Gres dominon tradita kulturore dhe fetare dhe familja e gjyshërve të mijë gjithashtu ishin të lidhur me fenë. Ashtu siç më rrëfente gjyshi im, babi im që në fëmijëri ishte tepër inteligjent dhe sillej si një i rritur. Ai i ndihmonte shumë prindërit dhe vizitonte fqinjët. Kur i pash librat e babait tim, kam kuptuar pikëpamjet e tij fetare dhe politike që ishin plotë kuptim dhe dije. Babi deri në moshën 25 vjeçare qëndroi në Pakistan dhe pas arritjes së gradës Mulla, u kthye në vendlindjen e tij. Ai gjithmonë ka punuar për t'i shërbyer vendit të tij, edhe përkundër faktit se kishte shumë propozime dhe sugjerime të mira për studim, ai prapë u kthye në vendlindjen e tij".

Malek Abdusamed Sadati, djali i profesorit të babait tim kështu më thoshte: "Kishte entuziazëm të madh për studim, bile studionte edhe fetë tjera dhe debatonte me klerikë të feve tjera". Ai e njihte mirë gjuhën angleze si dhe kishte njohuri të mëdha për jurisprudencën dhe trashëgiminë. Babai im në fshatin Gers ishte shumë i njohur dhe i dashur për njerëzit. Nëse dikush nuk binte dakord me bindjet e tij, ai asnjëherë nuk acarohet dhe me argumente fliste me ta. Ai gjithmonë diskutonte në mënyrë të qetë dhe me logjikë. Popullit i thoshte cila është arsyeja e bashkëpunimit të tij me rrymat revolucionare dhe çfarë po ndodhte me regjimin monarkist. Kur babai im u kthye në Iran, pas disa muajsh u martua dhe filloi edukimin e njerëzve, i vendoste në librin e tij deklaratat e Imamit dhe dalëngadalë i përhapte në mesin e njerëzve. Pas një kohe ai filloi të ligjëronte në hytben e xhumasë dhe themeloi shkollën për mësimin e fesë. Ai përdori çdo rast dhe mundësi për të edukuar njerëzit. Babai im kryente aktivitete revolucionare me Mulla Mohamed Jusef Husejnpur, i cili ishte drejtor i shkollës fetare dhe me persona tjerë si Mola Mohamed, klerik fetar. Shkruante parulla kundër regjimit dhe nxiste të rinjtë për t'u ngritur në protesta. Atë e kërcënonin grupe të ndryshme dhe kur atë e kërcënonin me vdekje, thoshte: "Nëse dëshironi më gjuani, por unë kurrë nuk do të ndalem me informimin dhe vetëdijesimin e njerëzve".

Disa herë ai ishte rrahur nga xhandarmëria. E mbaj mend njëherë kur njëherë fuqishëm me makinë goditën dyert e oborrit dhe ne u frikësua shumë.

Babai im edhe pas revolucionit i vazhdoi aktivitetet e tij në Gardën Revolucionare dhe u martirizua si pjesëtar i forcave vullnetare. Ai me të gjitha mundësitë e tij u angazhua për të eliminuar varfërinë materiale dhe shpirtërore të njerëzve. Ai mbledhte materiale ushqimore për Komitetin për ndihma humanitare dhe mirëqenie sociale dhe në koordinim me guvernatorin i shpërndante tek njerëzit. Më kujtohet që në fund të vitit 1980 ishte producent në televizion. Ai për publikun transmetonte filma dhe dokumentarë revolucionarë. Më 12 Maj 1981, anëtarët e grupit terrorist Monafekin e kanë qëlluar në gjumë në orën 12 të mesnatës e kanë martirizuar babain tim. Derisa ishte në gjumë ai u qëllua në kokë, pastaj atë e kanë drejtuar në drejtim të Kibles dhe kanë qëlluar me breshëri në drejtim të tij. Ai është goditur me 40 plumba. Nëna ime gjithmonë rrëfen se si babai im vazhdimisht ka theksuar për edukimin tonë. Gjithmonë na çonte neve në xhami për të falur namazin dhe për të mësuar leximin e Kur'anit.

Unë isha 8 vjeç kur babai im u martirizua".

Çështja e shkeljeve të të drejtave të njeriut në grupin terrorist Monafekin është një prej çështjeve që përsëritet nga ky grup për çdo vit me pretekste të ndryshme. Fal faktit se krerët e këtij grupi terrorist kujtojnë vazhdimisht të drejtat e grave, bota për çdo vit do të ketë mundësi të perceptojë shumë mirë llojin e vështimit të krerëve të grupit terrorist Monafekin ndaj grave dhe femrave.

mirëpo për popullin e Iranit i cili nga afër ka pa dhe ka përjetuar krimet e tmerrshme dhe sjelljet mesjetare të grupit terrorist Muxhahedine Khalk, sidomos në fillim të viteve 1980-ta, pretendimet e këtij grupi terrorist nuk kanë kurrfarë vlere.

Ikja e qindra pjesëtarëve të pakënaqur të grupit terrorist Muxhahedine Khalk nga kampet e Irakut dhe së fundi nga kampi i Shqipërisë drejt vendeve të ndryshme të botës dhe zbulimi i skandaleve dhe krimeve të këtij



Marjam Raxhavi, liderja e grupit terrorist Monafekin (Muxhahedine Khalk) e cila është emëruar në krye të këtij grupi nga bashkëshorti i tij dhe për të treguar gjestin e respektimit të të drejtave të njeriut, për çdo vit në raste të ndryshme mundohet që duke mashtruar opinionin publik ndërkombëtar, të blejë kredibilitet për sektin e saj dhe ta prezantojë atë si një alternativë demokratike dhe e mendimit të lirë për të zëvendësuar Republikën Islamike të Iranit.

Këto pretendime të grupit terrorist Monafekin mund të ketë efekt jashtë kufijve të Iranit dhe pranë atyre personave që nuk e njohin historinë e turpshme dhe të zezë të grupit terrorist Muxhahedine Khalk (Monafekin),

grupi nga ata, tregohet shumë qartë se femrat në këtë sekt deri në çfarë mase ndodhen në gjendje të mjerueshme dhe të tmerrshme. Detyrimi i femrave për të veshur rroba dhe uniforma të një modeli të njëjtë, divorci i detyruar i të gjithë atyre nga bashkëshortët, ndalimi i kontakteve mes grave dhe burrave brenda në kampet e grupit terrorist Muxhahedine Khalk, ndarja e fëmijëve nga nënat

e tyre në kampet e Muxhahedine Khalk dhe dërgimi i atyre fëmijëve në Evropë, sidomos në Gjermani, ndalimi i martesës së vajzave të pamartuara brenda këtij grupi, kurorëzimi i detyruar i të gjitha grave të këtij grupi me Masud Raxhavi, operacioni i detyruar i të gjitha femrave për të mos lindur sipas zbulimit

të grave që janë ndarë nga ky grup, mungesa e kushteve për arsimim për grat dhe burrat anëtarë të grupit terrorist Muxhahedine Khalk, ndalimi i femrave dhe grave anëtare të këtij grupi që të takohen me anëtarët e familjes së tyre të cilat kanë shkuar nga Irani; janë vetëm një pjesë sjelljeve të padurueshme dhe të paparamend uara të krerëve të grupit terrorist Muxhahedin e Khalk me femrat anëtare të këtij grupi.

Grat që kanë arritur të ikin dhe të ndahen nga grupi terrorist Muxhahedine Khalk, përbëjnë një pjesë të madhe të pjesëtarëve të ndarë të këtij grupi dhe në vete konsiderohet një çështje e rëndësishme. Raxhavi në të gjitha fjalimet e saj në prani të personave të cilët nuk janë të informuar për sjelljet dhe veprimet kundër të të drejtave të njeriut dhe çnjerëzore të këtij grupi, flet për të drejtat e grave dhe barazitë në familje dhe për lirinë e zgjedhjes së veshjes. Kjo është në kohën kur në mesin e

pjesëtarëve të këtij grupi nuk ekziston asnjë martesë dhe asnjë familje dhe femrat pjesëtare të këtij grupi, përkundër femrave iraniane, janë të kushtëzuar të veshin vetëm një lloj të veçantë të rrobave.

Femra në grupit Muxhahedine Khalk është një qenie pa vullnet e cila definohet në kuadër të dëshirave dhe qëllimeve të liderit të këtij grupi dhe në kuadër të besnikërisë ndaj tij. Edhe grat të

cilat në mënyrë sipërfaqësore ndodhen në nivelet më të larta të strukturave të grupit Muxhahedine Khalk, janë gra pa ndjenja dhe pa vullnet të vilat gjithashtu janë të zotuar që ta ndjekin liderin e grupit dhe bashkëshorten e tij pa kurrfarë hezitimi. Megjithëkëtë, lideri i grupit terrorist Muxhahedine Khalk padyshim se është personi i fundit i cili mund të deklarohet në lidhje me grat dhe të drejtat e tyre.



Parstoday është një sajt informativ iranien, i cili duke shfrytëzuar përvojën mbi 70 vjeçare të Shërbimit të Jashtëm të RTV të Iranit (IRIB Worldservice), ka filluar në një formë të re mediatike aktivitetin e tij në Janar 2016, duke transmetuar në mbi 30 gjuhë të botës lajme dhe informacione mbi zhvillimet kryesore në rajon dhe të botës.

Parstoday posedon shërbime mediatike si website, radio, transmetim përmes valëve në frekuencë, në internet dhe në celular si dhe në rrjetet sociale. Parstoday i transmeton informacionet për publikun në gjuhët shqip, arabisht, armene, bengale, kineze, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, hysa, hebreje, indiane, indoneziane, italisht, japoneze, kazake, savahili, pashtun, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht dhe numri i redaksive në gjuhë të huaja do të shtohet.

Zhvillimet politike në Lindjen e Mesme dhe roli i rëndësishëm i Iranit si një vend ndikues në rajon dhe si një vend i sigurt dhe në zhvillim, e shton edhe më shumë rëndësinë e Parstoday si një media me ndikim.

Parstoday në gjuhën shqipe ofron për publikun programe dhe emisione me tematika informative, politike, kulturore dhe fetare duke informuar opinionin me të pathënat e mediave botërore.

Programet e Parstoday në gjuhën shqipe ofrohen për miliona shqiptarë në rajonin e Ballkanit dhe në rajone të ndryshme të botës, të cilët janë të interesuar të njihen realisht me zhvillimet në Iran, në lindjen e Mesme dhe në vendet banuara nga popullsia shqiptare.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni me ne.

Parstoday.com/sq



albanian@parstoday.com

Tel: +98-21-22162833

Tel: +98-21-22162716

Celular: +98-903-5065501



facebook.com/ParsTodayAlbanian



instagram.com/parstodayalbanian



@ParsTodaySq